

Fakulteti i Shkencave Mjekësore
Programi Studimor-Biomedicinë
Cikli i tretë i studimeve të Doktoraturës

UT-Fakulteti i Shkencave Mjekësore
Vitezhmat 2019
Nr.-Bp. 22-365/1
20.02 2020 vit/год.
Tetovë - Tetovo

Fakultetit të Shkencave Mjekësore
Këshillit Mësimor Shkencor të FSHM-së
Tetovë

Në bazë të Vendimit të datës 30.12.2019 për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatit **Nagip Rufati** të miratuar nga *Këshilli-Mësimor Shkencor i Fakultetit të Shkencave Mjekësore të Universitetit të Tetovës*, u formua Komisioni për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatit **Nagip Rufati** në përbërje: **Prof.dr Kastriot Haxhirexha, Prof. Dr Lutfi Zylbeari, Prof. Dr Sadi Bexheti, Prof. Dr Nasir Bexheti, Prof. Dr Nexhbedin Beadini** Komisioni për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës pas shqyrtimit të kërkesës të kandidatit **Nagip Rufati** paraqet këtë:

Raport

për vlerësimin e punimit të disertacionit të doktoraturës të kandidatit **Nagip Rufati** me titull:
“Identifikimi i Citomegalloviruseve dhe Toksoplazmazave tek femrat si shkaktarë kryesorë të aborteve dhe sterilitetit primarë”

Punimi i disertacionit të doktoraturës së kandidatit **Nagip Rufati** si në aspektin stukturor po ashtu edhe në aspektin përmbajtësor dhe hulumtues-shkencor i plotëson kriteret e një punimi të mirëfilltë të doktoraturës.

Punimi i disertacionit të doktoraturës është i konceptuar në *Kapituj* dhe *Nënkapituj* dhe në kuadër të punimit janë përfshi: *108 faqe, 9 tabela, figura 9 dhe 12 grafikone.*

Punimi i disertacionit të doktoraturës së kandidatit **Nagip Rufati** është i strukturuar për nga aspekti përmbajtësor dhe metodologjik në: *Hyrje, Materiali dhe metoda e punës, Qëllimi i punës, Rezultatet, Diskutimi, Përfundimi, Summary dhe Literatura.*

I. HYRJA

Tek „**Hyrja**„ kandidati **Nagip Rufati** ka paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore të disertacionit të doktoraturës duke përshkruar tematika të problematikës së punimit të disertacionit të doktoraturës dhe ka cituar literaturë të shkëputur nga tematika e fushës përkatëse dhe të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese. Kandidati ka potencuar faktorë të riskut potencial të sëmundjeve me infeksione të citomegaloviruseve dhe toxoplazmozave dhe ka cituar fragmente të rëndësishme nga literatura vendase dhe botërore për ti dhënë edhe një karakter më bindës punës hulumtuese të këtij disertacioni të doktorature.

Citomegalovirusi human (CMV) është shkaktari më i shpeshtë i infeksioneve virale intrauterine dhe dëmtimeve të fetusit, kryesisht nga infeksioni primar maternal. Aborti tek gratë është një prej pasojave më të rëndësishme të infeksioneve gjenitale me *Chlamydia trachomatis*, *Mycoplasma hominis* dhe *Ureaplasma urealyticum*. Congenital Toxoplasmosis mund të shkaktojë abort, vdekje neonatale ose malformacion fetal me pasojë në fetus. Gjithashtu mund ta zvogëlë kualitetin e jetës të fëmijët të cilët i kanë mbijetuar infeksionit prenatal.

Citomegalovirusi human (CMV) është shkaktari më i shpeshtë i infeksioneve virale intrauterine dhe dëmtimeve të fetusit, kryesisht nga infeksioni primar maternal. Aborti tek gratë është një prej pasojave më të rëndësishme të infeksioneve gjenitale me *Chlamydia trachomatis*, *Mycoplasma hominis* dhe *Ureaplasma urealyticum*. Congenital Toxoplasmosis

mund të shkaktojë abort, vdekje neonatale ose malformacion fetal me pasoja në fetus. Gjithashtu mund ta zvogëlë kualitetin e jetës të fëmijët të cilët i kanë mbijetuar infeksionit prenatal.

Infeksioni i citomegaloviruseve tek fëmijët dhe të rriturit më së shpeshti është asimptomatik ndërsa tek të posalindurit mund të shkaktojë sëmundje të rëndë. Virusi përcillet me rrugë hematogjene, rrugë transplacentare prej nënës në fetus ose fetusi infektohet direkt gjatë kohës së lindjes gjatë kalimit nëpër rrugët e infektuara të lindjes, kontakti me gjakun ose sekretin vaginal të nënës. Infeksioni mund të ndodhë edhe pas lindjes nëpërmjet gjidhënies. Numri më i madh i të posalindurve nuk kanë simptoma të sëmundjes por 10 % prej tyre mund të kenë sëmundje të rëndë gjatë lindjes, edhe 10% mundet që më vonë të zhvillojnë simptoma të sëmundjes lidhur me infeksionin e CMV.

Sëmundje të rënda nga infeksioni i CMV tek të posalindurit ndodhin vetëm te infeksionet primare të shtatzënave, ndërsa tek infeksionet rekurente të CMV te shtatzënet infeksioni te i posalinduri më së shpeshti është asimptomatik ose i ndjekur me formë të lehtë të sëmundjes. Infeksioni i CMV te të posalindurit, i cili ndodh gjatë lindjes kryesisht është asimptomatik. Te format më të rënda të infeksionit të CMV i posalinduri ka hepatosplenomegali, trombocitopeni, koriorinitis dhe mikrocefali me letalitet të lartë. Më vonë tek fëmijët mund të paraqiten: dëmtime në të dëgjuarit, verbërim, ngecje në zhvillimin psikomotorik, çrregullim neurologjik etj.

Preventiva nga infeksioni i CMV përbëhet prej caktimit të antitruptave të këtij virusi te gruaja shtatzënë. Përderisa gruaja shtatzënë është seronegative deri në fund të shtatzanisë duhet të ketë kujdes në paraqitjen eventuale të antitruptave anti-citomegalovirus. Gratë shtatzënë duhet të paralajmërohen për infeksione të mundëshme nga fëmijët ose persona immunosuprimarë nga mjedisi ku jetojnë dhe të këshillohet që rregullisht të aplikojë masa për higjienë personale (ti lajë duart, të mos shfrytëzojë pajisje të përbashkëta ushqimore).

II.QËLLIMI I PUNIMIT

Tek „ **Qëllimi i hulumtimit,**” kandidati **Nagip Rufati** paraqet në mënyrë të thukhtë problematikën kryesore të qëllimit të punimit të disertacionit të doktoraturës duke përshkruar qëllimin esencial të fushës shkencore hulumtuese të këtijë punimi. Sidomos fokusimi i qëllimit të punimit është mbështetur në problematikën e fushës së gjinekologjisë dhe sidomos në fushën e infeksioneve gjatë shtatëzanisë.

- * Qëllimi i hulumtimit të ndikimit të citomegalovirusëve CMV, IgM, IgG, toksoplazmave TXM dhe TXG si shkaktarë potencial të sterilitetit dhe aborteve te gratë shtatëzëna është që të caktohet sa është shkalla e infeksionit prej citomegalovirusëve te gratë shtatëzëna.
- * Zbulimi në kohë të duhur i këtyre infeksioneve mund të ndihmojë në parandalimin e çrregullimeve gjatë shtatëzanisë, aborteve, sterilitetin primar dhe çrregullime kongjenitale tek fetusit.
- * Citomegalovirusi human (CMV) është një nga shkaqet kryesore të retardimit mendor dhe përmes çrregullimeve të tjera neurologjike tek fëmijët. Deri më sot nuk egziston një algoritëm i pranuar përgjithësisht për zbulimin e infeksionit intrauterin CMV gjatë shtatëzanisë dhe në periudhën neonatale.
- * Ne kemi kërkuar në materialin tonë për të zbuluar gra shtatëzëna me infeksion primar CVM me përcaktimin e indexit të aviditetit (IA) e antitruptave IgG.

III. METODA E HULUMTIMIT

Tek „ **Materiali dhe metoda hulumtuese,**„ kandidati **Nagip Rufati** paraqet në mënyrë të theksuar problematikën kryesore të metodologjisë hulumtuese të disertacionit të doktoraturës duke përshkruar në mënyrë të detajuar metodologjinë kryesore të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese. Kandidati ka përdorur metodologjinë më bashkëkohore për hulumtim duke u bazuar në metodat më të përsosura për hulumtim të mirëfilltë të kësaj problematike hulumtuese shkencore.

- * Metoda e matjes së vlerave të citomegalloviruseve dhe toksoplazmozave do të realizohet në laborator me metodën imuno assay fluorescent test me aparaturën Mini Vidas që ka një senzibilitet shumë të lartë të testeve edhe atë deri më 99 %.
- * Kampionet e përfshira në hulumtim do të meren nga Reparti Gjinekologjisë-Obstetrikës pranë Spitalit Klinik të Tetovës.
- * Në deri tani testuam kampionet në 28 gra shtatzëna nga java e 17 deri në javën e 37 të shtatzënisë. Serumet i testuam për praninë e antitruptave specifik CMV dhe IgG dhe indeksin e aviditetit për të përcaktuar aviditetin e antitruptave specifik IgG.
- *

IV. REZULTATET DHE DISKUTIMI

Tek „ **Rezultatet,**„ kandidati **Nagip Rufati** ka paraqitur dhe ka ilustruar në mënyrë tabelarësh, grafikonesh dhe figurave problematikën kryesore të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese. Rezultatet e fituara i ka shprehur në formë të ilustrimeve të qartësuar me vlera referente dhe vlera të fituar të cilat shprehin vlera determinante për diagnostifikimi e hershëm dhe të saktë të kësaj problematike.

Rezultatet e paraqitura nëpërmjet tabelave, grafikoneve dhe figurave janë të përpunuara me anë të metodologjisë më të sofistikuar *p value* dhe vlerave referente botërore. Këto rezultate do të japin një kontribut të çmuar për diagnostifikimin e sëmundjeve që janë të lidhura me sindromin

metabolik dhe sidomos tek sëmundjet kardiovaskulare. Rezultatete fituara do ti shërbejnë fushës së mjekësisë në përgjithësi dhe fushës së kardiologjisë në veçanti.

Tek diskutimi kandidatja ka parqitur në mënyrë shumë të detajuar problematikën e fushës hulumtuese dhe ka bërë krahasimin e rezultateve me shumë autor të vendit dhe sidomos me theks të veçantë potencojmë krahasimin e vlerave të kandidatës me vlerat referencë të shumë autoreve botërorë që merren me problematikën e kësaj fushe hulumtuese.

V.PËRFUNDIMI

Tek „**Përfundimi**„ kandidati **Nagip Rufati** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore dhe përfundimtare të tematikës së disertacionit të doktoraturës duke dhënë rekomandimet përfundimtare dhe finale të fushës së ngushtë të kësaj lëmie shkencore hulumtuese. Rezultatet e fituara nga kandidati gjithashtu i ka shprehur me ilustrime shumë të sjellura konkudimet e duhura dhe të mirëfillëta për këtë fushë hulumtuese shkencore.

- * Ky hulumtim do të kontribojë në evitimin e rasteve me infeksione dhe eliminimin e aborteve spontane të parakohshme në fushën e gjinekologjisë.
- * Numri më i madh i njerëzve të cilët punojnë me të posalindurit e sëmurë dhe fëmijët nuk janë në rrezik të sëmurës nga CMV. Sidoqoftë ekziston mundësi prej nënës tek fëmija i cili paraprakisht nuk ka pasur infeksion me CMV të përcillet in utero (në periudhën kur gjendet në mitrën e saj). CMV më së shpeshti përcillet në mes fëmijëve të rinjë, për shkak se CMV përcillet me kontakt edhe nëpërmjet lëngjeve trupore të infektuara duke kështu urinën dhe pështymën, personat të cilët ruajnë fëmijë (personat të cilët punojnë në edukimin e fëmijëve dhe terapeutëve) duhet të edukohen për infeksionet e CMV dhe të praktikojnë masat preventive.
- * Citomegalovirusët mund të shkaktojnë probleme serioze të personat të cilat janë me imunitet të dobësuar dhe fëmijët të cilët imuniteti akoma zhvillohet. Infeksioni i

quajtur Citomegalovirus mund të jetë i rrezikshëm për shtatzënat, në fakt për foshnjën të cilën e bartin.

- * Infeksioni i citomegalovirusëve, i cili sjell deri në anomali kongjenitale (mangësi të lindura) tek fëmijët, veçanërisht përderisa ka ardhur në infeksion në tre mujorin e parë të shtatzanisë. Përderisa vjen deri në infeksion gjatë kohës së shtatzanisë në 40% prej rasteve virusi kalon nëpërmjet placentës dhe infektohet fryti që mund të rezultojë me zhvillim të sindromit të citomegalovirusit kongjenital.
- * Nga hulumtimi ynë presim që të arrijmë deri tek zbulimi në kohë i pacienteve me citomegaloviruse dhe toksoplazmoza pozitive, detektimin dhe parandalimin e aborteve spontane sidomos në 3 mujorin e parë si dhe parandalimin e paraqitjes së sterilitetit primar dhe sekondar në rajonin e Pollogut dhe rrethinë.
- * Rezultatet e hulumtit tonë do të kontribuojnë dukshëm fushës së gjinekologjisë në veçanti dhe fushës së mjekësisë në përgjithësi.

VI. BIBLIOGRAFIA

Tek „**Bibliografia**„ kandidati **Nagip Rufati** paraqet në mënyrë të thuktë problematikën kryesore të tematikës së disertacionit të doktoraturës duke përshkruar dhe cituar literaturë përkatëse të fushës së ngushtë të kësaj lëmijë shkencore hulumtuese.


Tek ky punim doktore do të fokusohemi në literaturën më standarde më bashkëkohore dhe në mënyrë të drejtë do të citohen referencat e punimit të doktoraturës. Këto referenca të cituara do ta plotësojnë dhe do ti japin një karakter edhe më përmbajtësorë punimit të doktoraturës sepse do tu përkasin referencave më bashkëkohore të cituara me impakt ndërkombëtar, prandaj shiqar edhe nga ky aspekt ky punim do ti plotëson të gjitha standardet bashkëkohore të një punimi të mirëfilltë të doktoraturës.

Dukë u bazuar në të dhënat së temës së disertacionit të doktoraturës, konsiderojmë se ky punim i doktoraturës do të sjellë një risi tek identifikimi i Citomegalloviruseve dhe Toksoplazmozave tek femrat si shkaktarë kryesor i aborteve dhe sterilitetit primar dhe do të kontribuojë fushës së gjinekologjisë në vaçant dhe i dhe prandaj kërkojë nga **Këshilli Mësimor Shkencor të Fakultetit të Shkencave Mjekësore**, që ta pranojë dhe miratojë disertacionin e doktoraturës kandidatit **Nagip Rufati** me titull: **“Identifikimi i Citomegalloviruseve dhe Toksoplazmazave tek femrat si shkaktarë kryesorë të aborteve dhe sterilitetit primarë”**.

Tetovë më, 27.01. 2020

Anëtarët e komisionit:

Prof. Dr. Kastriot Haxhirexha



Prof. Dr. Lutfi Zylbeari



Prof. Dr Sadi Bexheti



Prof. Dr. Nasir Bexheti



Prof. Dr. Nexhbedin Beadini

